

VENDIM
Nr. 175, datë 29.8.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “BMG ENERGY SAL” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38 pika 1, germa “a” 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 91, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1569/10 prot., datë 28.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘BMG Energy SAL’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1569 prot., datë 1.7.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 141, datë 16.7.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.6.2024 dhe 21.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 1.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 11659 prot., datë 19.7.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Pas zhvillimit të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, në lidhje me dokumentacionin e munguar të aplikimit, me shkresën e fundit të protokolluar në ERE me nr. 1569/6 prot., datë 13.8.2024, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues.

- Me qëllim shqyrtimin dhe analizimin e këtij dokumentacioni dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 165, datë 15.8.2024, u vendos të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati për aplikimin e shoqërisë “BMG Energy SAL” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Pas zhvillimit të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë “BMG Energy SAL” sh.p.k., nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, germat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 germën “c”; për pikën 2.1 germat “b”, “c”, “d”, dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 3247 rep., nr. 2138 kol., datë 2.6.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, zonën Sheq

Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. marrëveshjen nr. 9511/2 prot., datë 13.10.2023, për lidhjen e centralit fotovoltaiik të shoqërisë “BMG Energy SAL” sh.p.k. me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 16.8.2024 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaiik në Fier BMG Energy SAL”, me fuqi 2 mw, me vendndodhje në Fier.

Me përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je (më 16.8.2024) dhe për shkak se shoqëria nuk ka arritur të fillojë punimet brenda këtij afati, ajo ka aplikuar më datë 23.8.2024 për t’u pajisur me një VNM të re. Në këto rrethana dhe referuar afateve të parashikuara në nenin 91, pika 2, të ligjit nr. 44/2025, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE, VNM-në paraprake të re brenda datës 23.10.2024.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret, shoqëria ka plotësuar në formatin përkatës afatin e pritshmërisë së jetëgjatësisë së centralit 49 vjet, sipas kontratës me MIE-n, por ka depozituar, gjithashtu, garancinë e paneleve që parashikon të përdorë, ku përcaktohet se garancia për panelet fotovoltaike është 30 vjet, ndaj dhe licenca do të jepet për 30 vjet, duke filluar ky afat nga data e parashikuar për fillimin e operimit, pra jo më vonë se data 31.3.2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “BMG Energy SAL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik jo më vonë se data 31.3.2025.

3. Shoqëria “BMG Energy SAL” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në Paraprake të re brenda datës 23.10.2024.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “BMG Energy SAL” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. dhe “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

